



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:186565

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05622744

A.nr.2186/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, F.B. nga komuna e ..., në adresën në Rr., kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës në Prishtinë-Departamenti i Pensioneve, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palës paditëse, ekspertëve mjekësorë dhe mungesë të palës së paditur, me datë 25.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet kërkesëpadia e paditëses, ... nga komuna e ..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi numër 6009401, i datës 14.03.2022, i të paditurës- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë dhe ti njihet e drejta në pensionin me aftësi të kufizuar të përhershme nga dita e paraqitjes së kërkesës, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Seanca mbi shqyrtimin kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të paditëses, në prani të ekspertëve mjekësorë dhe mungesë të paditurës e ftuara në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Paditësja përmes padisë së parashtruar në gjykatë me datën 12.09.2022, ka theksuar se, e paditura, në bazë të konstatimit të komisionit mjekësor nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm për të provuar se i takon kjo e drejtë, duke bërë kështu konstatim të gabuar të gjendjes faktike. E njëjta, me vendimin e kontestuar nuk ka arsyetuar drejtë dhe çartë, arsyet mbi të cilat i është refuzuar ankesa. Bazuar në të shënuarat, paditësja kërkon nga gjykata që të marrë aktgjykim me të cilin aprovohet padia dhe kërkesa e

saj, anulohet vendimi i kontestuar i të paditurës dhe paditëses ti njihet drejta në pension të personave me aftësi të kufizuar nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Ndërsa, paditësja në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën e saj përfundimtare kërkon nga gjykata të aprovohet kërkesëpadia e saj si e bazuar dhe të anulohet vendimi kontestues të paditurës, ashtu që ti me njihet e drejta e pensionit me aftësi të kufizuar nga dita e parashtrimit të kërkesës, deri me nxjerrjen e këtij vendimi, ndërsa pas kësaj date ti me njihet pensioni edhe për 5 vitet e ardhshme.

Ndërsa, ekspertet mjekësor në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën e saj përfundimtare, kanë deklaruar, se mbeten pran ekspertizës së datës 14.03.2024, me të cilën kanë konstatuar përqindjen e aftësisë së kufizuar ku sipas tabelës orientuese për zvogëlimin e aktivitetit jetësor është 25% që do të thotë se pacientja në fjale nuk është me aftësi të kufizuar të plote dhe ka aftësi të kufizuar parciale dhe nuk hyn në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar.

E paditura me përgjigje në padi të parashtruar me datë 09.11.2023, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konfrom të gjitha dispozitave në fuqi dhe i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadiës së paditëses në tërësi si të pabazuar duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor – publik të date 25.04.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi i dt.14.03.2022; Aktgjykimi numër 827/19 i dt. 17.11.2021; vendimi 14.03.2019;raporti i komisionit 23.11.2018; raporti nga konsulta 03.01.2019; raporti specialistik 23.11.2018; 15.11.2018; udhëzimi për konsultim 14.11.2018; Raporti nga konsulta i dt. 15.11.2018; raporti i komisionit 23.11.2018; fletëprcjellesi id t.20.05.2012; dhe 01.04.2013 ; fletë lëshimi 23.04.2013 numër të amzës 2625; raporti i dt. 01.07.2022; raporti i komisionit profesional 27.10.2017; Raporti kthyes i dt.14.01.2021; vërtetimi i dt.22.11.2018; vendimi idt.19.12.2017; raportet specialistike i dt.23.11.2018 dhe 15.11.2018; vendimi i dt.21.01.2015; vërtetimi i dt.04.12.2013;raporti 21.05.2013; vendimi i dt.14.03.2019; vendimi i dt.04.01.2019; kërkesa e dt.28.01.2019; vendimi i dt.14.03.2022; vlerësimi i komisionit mjekësor - konstatimi 23.12.2015; rivlerësimi 12.01.2015; shqyrtimi i ankesave 20.02.2014; dhe 27.12.2018; shqyrtimi i lëndes pas aktgjykimit i dt.02.03.2022; ekspertiza e dt.14.03.2024; raporti 21.04.2024; rezultate dt.21.02.2024; Raporti i dt.29.02.2024; vërtetimi i dt.18.02.2024; Raporti radiologjik 31.01.2024 dhe Raporti specialistik 15.02.2024 dhe 31.01.2024.

Gjykata duke vlerësuar vendimet e goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thëniet e padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Me vendimin e organit të shkallës së dytë të së paditurës, të goditur me padi, është refuzuar ankesa e paditëses për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar të përhershme, me arsyetimin se Komisioni, në shkallë të dytë, duke i'u referuar dokumentacionit të lëndës konstatoi se në seancën e datës 02.03.2022, nuk ekziston aftësia e përhershme e kufizuar, dhe përkundër gjendjes së paraqitur, nuk i plotëson kushtet për shfrytëzimin e kësaj të drejte, sipas nenit 9 të Ligjit nr. 2003/23, ka ardhur në përfundimin se, tani paditësja, nuk i plotëson kriteret e parapara me dispozitat e lartëshënuara, për të qenë përfitues i pensionit të personave me aftësi të kufizuar të përhershme, dhe se pajtohet me vlerësimin e komisionit të shkallës së parë se nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj.

Kjo gjykatë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit kontestues ka konstatuar se, organet administrative, drejt kanë zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 2003/23, për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, respektivisht nenin 2.2, dhe 3, ku përcaktohet: “2.2 Ministria formon Komisionin Mjekësor për të përcaktuar për zgjedhshmërinë mjekësore për pensionet e aftësisë së kufizuar. Ministria cakton Administratën Pensionale të Kosovës për të administruar këtë skemë të pensioneve të aftësisë së kufizuar. Komisionet mjekësore do ta kryejnë punën nën menaxhimin dhe kontrollin e autoritetit përkatës. Ministria mund të caktojë organe të tjera për të përcaktuar përzgjedhshmërinë dhe për t'i administruar pagesat e kësaj skeme dhe të parashohë me dispozitë, që Ministria drejtpërdrejtë t'i administrojë komisionet mjekësore: (...) 3.1 Për të fituar të drejtën në pension të aftësisë së kufizuar parashtruesi i kërkesës duhet të ketë banim të përhershëm në Kosovë dhe t'i përmbushë kërkesat, sipas këtij ligji, që duhet përmbushur për pension të aftësisë së kufizuar (...) 3.2 Komisionet mjekësore do të vlerësojnë gjendjen shëndetësore të parashtruesve të kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar. Vlerësimet e aftësisë së kufizuar nga ana e komisioneve mjekësore duhet të jenë me shkrim dhe duhet të përfshijnë me sa vijon: (a) Deklaratën e posaçme të diagnozës për gjendjen fizike, ndijore apo mendore, sëmundjen apo aftësinë e kufizuar prej së cilës parashtruesi i kërkesës vuan dhe datën e paraqitjes së gjendjes, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar; diagnoza duhet të përshkruajë gjendjen shëndetësore, sëmundjen apo aftësinë e kufizuar si dhe adikimin e posaçëm të gjendjes shëndetësore, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar në punësim, duke përfshirë përshkrimin e thukët të funksionimit të dobësuar të parashtruesit të kërkesës. (b) Vlerësimin e funksionimit të parashtruesit të kërkesës për sa i përket detyrave të përditshme dhe atyre lidhur me punësim; ky duhet të përfshijë referencën e punësimit të mëparshëm të parashtruesit të kërkesës, nëse ka qenë i punësuar. (c) Përcaktimi se a mund apo nuk mund të punësohet parashtruesi i kërkesës, në çfarëdo cilësie, duke i pasur parasysh rrethanat e përgjithshme të sëmundjes ose aftësisë së kufizuar. (d) Përcaktimi i aftësisë së plotë të kufizuar për një periudhë prej një viti apo më gjatë, gjatë së cilës kohë parashtruesi i kërkesës ka qenë i paaftë për punësim të shpërblyeshëm. (e) Propozimi i aftësisë së kufizuar

të përhershme ...”, dhe të dispozitave pasuese të këtij ligji, në bazë të të cilave edhe është refuzuar kërkesa, respektivisht, ankesa e tani paditëses, që t’i njihet e drejta në Pension të Personave me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, meqenëse ankuesja, para komisioneve, nuk ka ofrua dëshmi të mjaftueshme, që dëshmon se i plotëson kriteret e përcaktuara të ligjit në zbatim.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditëses se nuk është vlerësuar drejtë gjendja shëndetësore saj, të njëjtat si te tilla, në këtë çështje administrative nuk i pa me ndikim në një vendosje tjetër nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse nga provat e administruara, gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 2.2 dhe 3 të Ligjit nr. 2003/23, në lidhje me nenin 9 paragrafit 5 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, vërtetoi se e paditura ka vlerësuar drejt gjendjen faktike pasi që paditësja nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme para komisionit në shkallës se dytë me ankesë për të dëshmuar se ka plotësuar kushtin ligjor të përcaktuar që kërkohet për njohjen kësaj të drejte. Gjykata në veçanti krijoi bindjen nga ekspertiza e datës 14.03.2024, e ekspertëve mjekësorë te certifikuar nga KGJK-ja, me të cilën kanë konstatuar se, mbetem pranë Ekspertizës se datës 14.03.2024 me të cilën kemi konstatuar qe paditësja pas ekzaminimit direkt rezulton diagnoza qe i përgjigjet gjendjes pas heqjes se gjirit dhe marrjes dhe aplikimit te 30 seancave te radioterapise dhe marrjes se hormonoterapisë 10 vite, gjendje te cilën pacienti vazhdon ta përshkruajë prej shume vitesh me shume ankesa. Andaj ne si ekspert kan vërtetuar përqindjen e aftësisë se kufizuar ku sipas tabelës orientuese për zvogëlimin e aktivitetit jetësor është 25% qe do te thotë se pacientja ne fjale nuk është me aftësi te kufizuar të plotë dhe ka aftësi te kufizuar parciale dhe nuk hyn ne kategorinë e personave me aftësi te kufizuar”.

Prandaj për faktin se, paditësja nuk ka ofrua dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata kërkesëpadinë e saj e refuzojë si të bazuar meqë vlerësoj se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të eksperteve, ekspertiza është e qartë, nuk ka kontradiktoritet në vete, nga vlerësimi i përgjithshëm ka krijuar bindje se ekspertiza e nxjerrë nga ekspertët mjekësorë te certifikuar nga KGJK-ja, është provë e besueshme e paanshme për të vendosur çështjen dhe të njëjtës ia fali besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material, kur ka refuzuar ankesën e ankueses këtu paditëses

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditëses dhe gjen se të njëjtat në këtë çështje administrative, nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së cekur ligjore, është vërtetuar se paditësja nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar- pensionin me pa atësi të përhershme.

Nga kjo, gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 63 e lidhur me nenin 21 Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin Ligjit, Nr.03/L-006 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTI
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2186-2022- datë: 25.04.2024

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.